



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 127 Akti

Nr. 146 Vendimi

Tiranë, më 13.5.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Firdes Shuli	Anëtar
Roland Ilia	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, më datë 8 maj 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sotir Kllapi**, me detyrë prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016)

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit** është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5, të nenin 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. **Subjekti i rivlerësimit, z. Sotir Kllapi**, me funksionin prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “**Komisioni**”), ka hedhur shortin në datën 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.1, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Firdes Shuli dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.3.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Sotir Kllapi.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim PP).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 18.1.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), me anë të së cilës dërgohej një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sotir Kllapi.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 25.4.2018), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Sotir Kllapi.*

10. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. ***prot., datë 29.5.2018.

11. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tri kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës, në datën 21.03.2019, vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Sotir Kllapi; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit, në datën 21.3.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 26.3.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 29.3.2019.

14. Në datën 26.3.2019, për shkak se subjekti kishte kërkuar kohë për t'u njohur me rezultatet e hetimit, nisur nga fakti se gjatë fazës së dërgimit të rezultateve pranë Komisionit erdhën disa indice, u rihapën procedurat e hetimit. Subjektit iu ridërguan rezultate shtesë të hetimit dhe në datën 6.5.2019, ka kthyer përgjigje lidhur me rezultatet shtesë të hetimit.

15. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet e tij në rrugë zyrtare, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, në datën 06.05.2019, vendosi të ftojë z. Sotir Kllapi, në këtë seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 07.05.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në datën 08.05.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve subjekti i rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Sotir Kllapi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit Nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese, dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga Prokuroria e Përgjithshme;

^[1] “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr.84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka mosdeklarime të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, të datës 26.1.2017, me nr. indeksi ***, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, për vitet 2009 – 2016, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;

ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruarra nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

- ❖ **Blerë kuota** në fondin e investimeve në “Raiffeisen Prestigj”, në shumën prej 2.500.000 lekësh. Shuma në fjalë është investuar në këtë formë, në vend të një depozite pranë kësaj banke.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”

Kursimet ndër vite nga punësimet e subjektit në vende të ndryshme dhe një pjesë të dhuruara nga prindërit e subjektit ndër vite.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, përgjigjen e “Raiffeisen Invest” dhe DPPPP-së.*

Komisioni, kreu hetim lidhur me vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

Sipas dokumentit “Urdhër blerje kuotave në fondin e investimit” të “Raiffeisen Invest”, subjekti ka krijuar fondin e investimit me vlerë 2.500.000 lekë, në datën 21.10.2016.

Subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009, ka deklaruar të ardhura si gjendje në shumën prej 1.100.000 lekësh dhe 500 eurosh. Burimi i të ardhurave në lekë janë 700.000 lekë nga kursimet e subjektit nga paga dhe 400.000 lekë si dhuratë nga kursimet e të ardhurave të prindërve.

Në deklaratat periodike ndër vite, nga viti 2009 deri në vitin 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura mbajtur si gjendje *cash* në shumën totale prej 3.600.000 lekësh dhe 500 eurosh.

Të ardhurat e subjektit në total nga marrëdhëniet e punës kanë qenë në shumën 8.979.771 lekë dhe deri në vitin 2009 të ardhurat e subjektit kanë qenë në shumën prej 1.487.123 lekësh, kurse shpenzimet në shumën prej 751.797 lekësh. Bazuar sa më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi kursimi deri në vitin 2009, shumën prej 700.000 lekësh.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion dokumentacion provues lidhur me mundësitë financiare të prindërve për dhurimin e shumës prej 400.000 lekësh para fillimit të detyrës. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti “vërtetime për bazën e vlerësueshme të ISSH-së” dhe *statement* nga “Raiffeisen Bank”, datë 22.2.2019, është vërtetuar deklarimi i subjektit dhe mundësia financiare e prindërve për krijimin e shumës prej 400.000 lekësh.

Krijimi i kësaj depozite si fond investimi është bërë në tetor të vitit 2016 dhe deri në këtë periudhë subjekti ka deklaruar se i ka disponuar këto fonde në gjendje *cash*.

Subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni lidhur me deklarin për blerje kuotash në fondin e investimeve pranë “Raiffeisen Prestigj” në vitin 2016, se sa ka qenë vlera e të ardhurave nga marrëdhëniet e punës dhe vlera e të ardhurave nga prindërit lidhur me krijimin e këtij likuiditeti.

Në përgjigjet e dërguara pranë Komisionit, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka sqaruar se: *“Shuma e kursimeve të mia dhe të ardhura nga prindërit e tejkalojnë shumën e investimit, por nuk mund të jap një përgjigje të drejtpërdrejtë. Nga shuma totale të akumuluar prej 3.6 milion lekësh kam investuar më datë 21 tetor 2016 shumën prej 2.5 milion lekësh dhe pjesën tjetër e kam mbajtur cash”.*

Arsyetimi ligjor

Gjatë fazës së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni rezultoi se të ardhurat e dokumentuara në total të subjektit nga marrëdhëniet e punës, si dhe bazuar dhe në deklaratat periodike vjetore të deklaruara, justifikojnë gjendjen e likuiditeteve të krijuara nga subjekti i rivlerësimit.

Në të tilla rrethana faktike dhe juridike, Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit duken bindëse dhe të bazuara në prova, dhe se nuk ka dyshime lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Në përfundim konstatohet se:

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë pasuri të krijuar nga subjekti i rivlerësimit.

- ❖ **Gjendje cash** në vlerën prej 1.150.000 lekësh dhe 500 eurosh.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”

Nuk është deklaruar burimi i krijimit nga subjekti i rivlerësimit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: *Gjendja cash e deklaruar justifikohet nga të ardhurat e subjektit ndër vite.*

Komisioni kreu hetim lidhur me vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit bazuar në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën “Vetting”, lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

Gjatë fazës së hetimit të kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën “Vetting”, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës *cash*. Kjo gjendje *cash* është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, si dhe është deklaruar edhe shtimi i gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore, duke filluar nga vitit 2010 deri në vitin 2016.

Subjekti i pyetur për këtë pasuri, ka deklaruar se:

“Konstatimi i Komisionit është i drejtë, por është bërë një pasaktësi në plotësimin e deklaratës “Vetting” nga ana ime.

Nga shuma totale e akumuluar prej 3.6 milion lekësh, kam investuar në datën 21 tetor 2016, në "Raiffeisen Invest" shumën prej 2.5 milion lekësh dhe pjesën tjetër e kam mbajtur cash".

Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite:

- Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009 subjekti ka deklaruar të ardhura si gjendje shumën 1.100.000 lekë dhe 500 euro.
- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në vlerën 200.000 lekë.
- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtim të gjendjes *cash* në vlerën 500.000 lekë.
- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtim të gjendjes *cash* në vlerën 250.000 lekë.
- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtim të gjendjes *cash* në vlerën 250.000 lekë.
- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2014 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në vlerën 400.000 lekë.
- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2015 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në gjendje *cash* në vlerën 500.000 lekë.
- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në gjendje *cash* në vlerën 450.000 lekë.

Arsyetimi ligjor

Hetimi i kryer nga Komisioni u përqendrua në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga deklarimi për herë të parë deri në deklaratën "Vetting".

Në përfundim konstatohet se:

Lidhur me mosdeklarimin e burimit në deklaratën "Vetting" Komisioni konkludoi se kemi të bëjmë thjesht me një pasaktësi në deklarin e cila nuk mund të konsiderohet problematike me qëllim penalizimin e subjektit të rivlerësimit. Gjendjen *cash* dhe ndryshimet e këtyre likuiditeteve, subjekti i ka deklaruar saktë në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, si dhe në të gjitha deklaratat periodike vjetore deri në vitin 2016.

Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje përputhet, si edhe nuk ka dyshime lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

- ❖ **Vlera prej 98.000 lekësh** në llogarinë rrjedhëse bankare nga paga, shumë kjo jo e ngurtësuar, por që mund të tërhiqet për konsum të përditshëm.

Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting"

Të ardhurat e subjektit nga paga.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: *ILDKPKI-ja nuk është shprehur lidhur me këtë pasuri të subjektit.*

Arsyetimi ligjor

Gjatë fazës së hetimit, bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, të “Raiffeisen Bank”, ka rezultuar se subjekti disponon llogari page në gjendje, në datën 21.1.2017, në vlerën prej 107.134 lekësh.

Është konstatuar se gjendja e llogarisë bankare prej 107.134 lekësh nuk përkon me deklarimin e subjektit në vlerën prej 98.000 lekësh. Kjo mospërputhje korrespondoi me faktin e datës së deklarimit nga subjekti në deklaratën “Vetting” (datë 26.1.2017), me datën e përgjigjes së “Raiffeisen Bank” (datë 21.1.2017).

Në përfundim konstatohet se:

Gjatë hetimit nga Komisioni ka rezultuar se kjo llogari është llogari page e cila ndryshon në varësi të pagesave të kryera për të ardhurat nga puna dhe tërheqjet e subjektit, dhe për këtë shkak nuk janë konstatuar problematika të mëtejshme nga Komisioni.

3. Analiza financiare

Komisioni kreu një analizë financiare për vitet para, ku gjatë të cilave, për shkak të funksionit, z. Sotir Kllapi, është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, për të cilat janë dërguar së bashku me dosjen e ILDKPKI-së edhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti.

Shpenzimet e jetesës janë bazuar tek deklaratimet në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënat e INSTAT-it.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me analizën financiare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Dua të saktësoj se një pjesë të muajve të këtij viti shpenzimet mesatare mujore, kanë qenë më të ulëta se vlera e llogaritur nga Komisioni, mesatarisht 41.000 lekë në muaj, pra kanë qenë 37.000 lekë, sikurse kam deklaruar”.*

Në përfundim konstatohet se:

Bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT dhe ILDKPKI-së, lidhur me llogaritjen e shpenzimeve mesatare mujore, subjekti i rivlerësimit nuk ka probleme lidhur me burimet financiare për vitet para dhe gjatë ushtrimit të funksionit si prokuror dhe rezulton me një bilanc pozitiv.

❖ Në lidhje me qiratë

Komisioni, gjatë fazës hetimore, konstatoi se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës si prokuror kishte përdorur dy pasuri të paluajjtshme më qira në qytetin e Tiranës dhe të Pogradecit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Gjatë fazës së hetimit të kryer nga Komisioni është konstatuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë deklaruar në deklaratën “Vetting” detyrime që lindin nga kontratat e qirave në qytetin e Tiranës dhe të Pogradecit. Gjithashtu, edhe në deklaratat periodike nuk janë deklaruar të plota detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet e qirasë.

Për këtë është pyetur subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: *“Nga viti 2008 kam kontratë me Rezidencën Studentore dhe paguaj 8.000 lekë çdo muaj. Që prej muajit*

korrik 2014 kam paguar detyrime për vlerën e qirasë në qytetin e Pogradecit në shumën prej 6.000 lekësh në muaj. Për këtë nuk kam kontratë formale me qiradhënësin, por vetëm një kontratë verbale. Për këtë fakt kam paraqitur deklaratën noteriale të datës 25 shkurt 2019, të lëshuar nga qiradhënësit. Në kohën e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës “Vetting” nuk kam pasur detyrime që rrjedhin nga marrëdhëniet e qirasë. Lidhur me shpenzimet mujore nuk mund të jap një shifër të saktë, por me afërsi janë 37.000 – 45.000 lekë në muaj, pa u përfshirë këtu kostoja e qirave dhe në varësi të viteve”.

Të dhënat lidhur me vlerat financiare dhe shpenzimet e subjektit nga kontratat e qirasë janë përfshirë në analizën financiare.

Për këtë konstatim lidhur me qiratë, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime edhe në rezultatet e hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi: “Lidhur me këtë çështje kam deklaruar se nuk ka qenë detyrim deklarimi i shumave të qirasë për shkak të vlerës së ulët të shpenzimit nën pragun ligjor të deklarimit (300.000 lekë). Gjithashtu, për këto kontrata nuk kam pasur detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë, në datën e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës Vetting”.

Në përfundim konstatohet se:

Nga ana e Komisionit nuk u konstatuan problematika për këtë çështje pas përgjigjeve të dërguara nga subjekti i rivlerësimit.

B. NË LIDHJE ME KONTROLLIN E FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, DSIK ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 25.4.2018), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Sotir Kllapi”. Ky raport është i deklasifikuar plotësisht.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

C. NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale është bazuar në raportin e hartuar nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin:

- a. e formularit të vetëdeklarimit, të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga ana e subjektit;
- b. e pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe
- c. e të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

Raporti është kontrolluar dhe vlerësuar nga relatori i çështjes, i cili ka paraqitur përpara trupit gjykues të Komisionit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Sotir Kllapi.

❖ **Për katër çështje të përzgjedhura me short**

Në katër dosjet e përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

❖ **Për një çështje të përzgjedhur me short**

Në një nga dosjet penale të përzgjedhura me short ka rezultuar procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 20.7.2015, për veprën penale “*Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, në ngarkim të z. P.Gj. Me vendimin e datës 2.9.2016, në bazë të germës “b” të nenit 328 dhe germës “ç” të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale subjekti ka vendosur: “*Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015, ndaj personit nën hetim, z. P.Gj., për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal.*

Hetimet kanë nisur në datën 20.7.2015. Subjekti i rivlerësimit në datën 20.10.2015 ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor për këtë procedim penal për tre muaj, në bazë të neneve 324 dhe 325 të Kodit të Procedurës Penale. Arsyetimi i zgjatjes së hetimeve është mosdorëzimi ende i aktit të ekspertimit autoteknik nga eksperti Y.H.

Në datën 20.1.2016 subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë sërish hetimet për një periudhë prej tre muajsh, me arsyetimin se nuk ka qenë dorëzuar ende akti i ekspertimit autoteknik nga eksperti Y.H.

Në datën 20.4.2016 sërish është vendosur zgjatja e afatit të hetimeve edhe për tre muaj të tjerë, me arsyetimin se ende nuk është dorëzuar akti i ekspertimit autoteknik nga eksperti Y. H.

Në datën 20.7.2016 është vendosur sërish zgjatja e afatit të hetimit për tre muaj, për shkak të mosdorëzimit sërish të aktit të ekspertimit autoteknik nga eksperti Y.H.

Për këtë çështje rezultoi se hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit kanë zgjatur rreth një vit e një muaj.

Në datën 20.1.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve, duke përdorur si shkak mosdorëzimin e aktit të ekspertimit nga eksperti Y.H. Në të vërtetë, ky akt ekspertimi tashmë ishte dorëzuar dhe, nga ana e subjektit, janë ndërmarrë kryerja e një sërë veprimesh procedurale, që kishin të bënin me zëvendësimin e masës së sigurimit për personin nën hetim. Duke parë vijueshmërinë e hetimeve, konstatohet se në datën 20.2.2016, subjekti ka marrë vendimin për kryerjen e riekspertimit autoteknik. Pra, arsyetimi korrekt i zgjatjes së afatit të hetimeve duhet të ishte zbatimi i planit hetimor që ai kishte vendosur, ashtu siç është shprehur vetë subjekti edhe në kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit dhe, konkretisht, kryerja e riekspertimit autoteknik.

Në vijim, edhe vendimet e tjera të zgjatjes së afatit të hetimit, konkretisht ato të datave 20.4.2016 dhe 20.7.2016, si arsytim korrekt kanë pritjen e administrimit të aktit të riekspertimit autoteknik. Në të vërtetë, në këto vendime konstatohet se nga ana e subjektit është dhënë si arsytim zgjatja e afatit të hetimeve për shkak se nuk është administruar akti i parë i ekspertimit autoteknik. Rezulton se subjekti nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur aktit të përpiluar nga ai vetë, pra, vendimeve të zgjatjes në lidhje me arsyetimin, megjithëse shkak ligjor ka ekzistuar për këto zgjatje. Në dosje nuk gjendet e administruar ndonjë e dhënë se kur është administruar akti i riekspertimit autoteknik apo se kur është kryer ai, por në datën 29.7.2016, ekspertët kanë nënshkruar deklaratën e ekspertit në bazë të nenit 183 të Kodit të Procedurës Penale.

Ndaj vendimit të pushimit, në lidhje me procedimin penal të sipërcituar, rezulton të jetë ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, nga shtetasja B.D., bashkëshortja e të ndjerit B.D., me objekt *“Kundërshtimin (anulimin) e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. s’ka, i marrë në datën 2.9.2016 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”*. Nga ana e subjektit në gjykimin e kësaj çështje janë përgatitur konkluzionet datë 11.4.2017, duke u kërkuar në bazë të nenit 328 dhe të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale, mospranimi i kërkesës, me arsyetimin se fakti nuk përbën veprë penale.

Lidhur me këtë çështje është pyetur subjekti dhe, në përgjigje të rezultateve të hetimit të dërguar nga Komisioni, ka deklaruar: *“Qëndrojnë konstatimet e Komisionit në lidhje me disa pasaktësi (gabime materiale) në vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve. Në këto vendime gabimisht është referuar si arsytim pritja e aktit të ekspertimit nga eksperti, akt i cili ishte dorëzuar, por duhet të arsyetohej se zgjatja e afatit bëhet me qëllim për t’u administruar akti i ekspertimit autoteknik i përgatitur nga grupi i ekspertëve. Sqarohet se këto gabime kanë ardhur si rezultat i ngarkesës në punë, i punimit mbi një model të mëparshëm dhe i shpejtësisë në hartimin e tij. Këto gabime materiale nuk kanë sjellë pasoja për procesin, pasi vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe nga Gjykata e Apelit Korçë”*.

❖ **Për çështjen penale ndaj shtetasit F.B.**

Pas hetimit të kryer nga Komisioni lidhur me indicet dhe parashtrimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në datën 28.3.2019 ka rezultuar se subjekti rivlerësimi ka ndjekur procedurat hetimore në vitin 2016 dhe, më pas, procesin gjyqësor ndaj të pandehurit F.G.B., në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Rezulton se nga prokurorja, znj. E.B., e caktuar për ndjekjen e masës së sigurisë, ndaj shtetasit F.B., është regjistruar procedimi penal nr. ***, i vitit 2015, për veprën penale *“plagosje e rëndë me dashje”* dhe *“prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”*, të parashikuar nga neni 88 dhe neni 278/4 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me vendimin nr. ***, datë 9.10.2015, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit F.B., atë të arrestit në burg, i dyshuar për veprën penale *“plagosje e rëndë me dashje”* dhe *“prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve...”*. Sipas arsytimit në vendimin e gjykatës rezulton se në datën 16.9.2015, në spitalin e Pogradecit është paraqitur i plagosur me armë zjarri shtetasi G.K. Nga hetimet paraprake ka rezultuar se autor i veprës penale është shtetasi F.B., i cili është larguar në drejtim të paditur menjëherë pas kryerjes së veprës penale.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit, pas caktimit si prokuror i kësaj çështjeje, me shkresën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec është kërkuar: *të bëhet verifikimi i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit dhe ligjërimi i masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin F.B.*

Në përfundim të hetimit dhe me dorëzimin e konkluzioneve përfundimtare për këtë çështje në gjykatë, nga ana e subjektit është kërkuar: *“Deklarimi fajtor i të pandehurit F.B., për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe të mbajtjes pa leje në banesë të armëve luftarake”,* parashikuar nga neni 275/5 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre vjet burg.

Në dorëzimin e konkluzioneve përfundimtare u vu re se nuk është kërkuar nga ana e subjektit deklarimi fajtor i të pandehurit, sipas procedimit penal të regjistruar, lidhur me veprat penale *“të plagosjes së rëndë me dashje”* dhe *“prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve në mjedise publike...”* Pra, lidhur me akuzat e ngritura që në fillim nga prokurorja që ka ndjekur masën e sigurisë, znj. E.B., nga ana e subjektit ka pasur një lehtësim në gjykimin e këtij shtetasi. Në arsyetimin e vendimit të subjektit theksohet: *“Nga sa rezulton, dëmtimet që i janë shkaktuar të dëmtuarit G.K., si pasojë e qitjes me armë zjarri, të shkaktuara nga i pandehuri F.B., janë të kategorisë së plagosjes së lehtë.”*

Ndërkohë, sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 28.9.2015 të kryer pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore rezulton se në trupin e të dëmtuarit konstatohet një plagë tejshkuese dhe dëmtimet hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë dhe është e detyrueshme paraqitja e të dëmtuarit në Institutin e Mjekësisë Ligjore pas një periudhe 6-mujore nga data e dëmtimit.

Në kushtet kur i dëmtuari ka hequr dorë nga ndjekja penale për veprën penale “të plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, akuza për këtë vepër penale ndaj të pandehurit F.B., është pushuar.

Në fakt, akuza për të pandehurin ka qenë *“plagosje e rëndë me dashje”*, sipas regjistrimit të veprës penale dhe masës së sigurisë së caktuar. Gjithashtu, sipas dispozitave të procedimit penal në fuqi, heqja dorë e të dëmtuarit për veprat penale *“plagosje e rëndë”* nuk sjell detyrimisht pushimin e veprës penale për të akuzuarin.

Gjithashtu, nuk shpjegohet se si subjekti ka bërë ndryshimin e akuzës gjatë gjykimit të çështjes në gjykatë. Mbetet për t’u theksuar se i pandehuri nuk ishte në kushtet e përfitimit të rrethanave lehtësuese edhe për shkak se pas kryerjes së veprës ishte fshehur, duke i ikur dhe duke iu shmangur drejtësisë (masa e sigurisë ka qenë në mungesë), dhe se rezultonte i dënuar po për të njëjtën vepër penale edhe më parë me vendimin nr. ***, datë 9.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (dënuar për veprat penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe për kanosje).

Rezultoi se shtetasi F.B., ka mbajtur në mjedise publike armë luftarake duke cenuar rendin dhe sigurinë juridike.

Subjekti, në përfundim të gjykimit ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit F.B., për veprën penale *“prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe të municionit”*, parashikuar

nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre vjet burg. Subjekti, bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin e të pandehurit me dy vjet burg. Në këtë përfundim nuk është mbajtur parasysh se neni 278/5 i Kodit Penal është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016. Pra, referenca ligjore e kërkuar nga ana e subjektit dhe e referuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me anë të vendimit gjyqësor duket pak e paqartë dhe, në dukje, duket dhe se është e gabuar, dhe kjo çështje duhet të ndiqej nga subjekti i rivlerësimit dhe në gjykatat e tjera më të larta. Ndryshimet e nenit 278/5 të Kodit Penal pas shfuqizimit të disa dispozitave nga Gjykata Kushtetuese janë miratuar me ligjin nr. 82/2016, datë 25.7.2016, pra, katër ditë para vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për të pandehurin F.B.

Ky qëndrim favorizues ndaj të pandehurit F.B., rezultoi se ishte mbajtur nga ana e subjektit edhe në çështjen tjetër penale të ndjekur për këtë person dhe të përfunduar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. ***, datë 27.7.2018. Vlen të theksohet se akuza penale për të pandehurin F.B., ka qenë po “*mbajtje pa leje e armëve*” bazuar në nenin 278/3 të Kodit Penal. Referenca e bërë për këtë veprë penale nuk është në përputhje me rrethanat e çështjes dhe me hetimin e kryer. Theksojmë se në nenin 278/3 të Kodit Penal përcaktohet: “*Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet*”, kurse i pandehuri ishte ndaluar në ambiente publike dhe ishte përsëritës dy herë me po të njëjtën veprë penale. Referimi i gabuar i nenit 278/3 të Kodit Penal ka qenë favorizues për shtetasin F.B., gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe dhënies së vendimit, pasi referimi i saktë duhet të ishte neni 278/1 i Kodit Penal, pasi ky referim ka qenë i përcaktuar nga subjekti që në fazën e fillimit të hetimeve dhe të caktimit të masës së sigurisë. Neni 278/1 i Kodit Penal parashikonte dënim për këto vepra penale me 3 vjet deri në 7 vjet burg. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dënimin me 1 vit e 8 muaj burg dhe gjykata ka vendosur dënimin me 12 muaj burg. Nuk rezultoi të jetë ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit mbi këtë vendim gjyqësor.

Lidhur me këtë çështje i është kërkuar subjektit të rivlerësimi të paraqiste sqarime lidhur me:

- *ndryshimin e referencës së veprës penale nga plagosje e rëndë me dashje në plagosje të lehtë;*
- *referencën e gabuar të nenit 278/5 të Kodit Penal dhe të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016;*
- *ndryshimin e referencës dhe bazës ligjore nga “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake në publik”, të parashikuar nga 278/4 i Kodit Penal, në “prodhim dhe mbajtje pa leje në banesë.....” për të dyja çështjet e sipërpërmendura;*
- *mosndjekjen e procedurave të ankimit të vendimit të gjykatës për të dyja çështjet e sipërpërmendura.*

Në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit subjekti deklaroi: “*Kategoria e dëmtimeve, përshkrimi dhe lloji i tyre, bëhen mbi bazën e ekzaminimeve dhe konsideratave mjeko-ligjore dhe nuk janë në kompetencën e organit procedues. Ekspertët janë shprehur se dëmtimet janë të kategorisë që kanë shkaktuar humbje të përkohshme të aftësisë në punë në masën mbi nëntë ditë dhe në referim të neneve 88/1 dhe 89 të Kodit Penal ka rezultuar se pasoja e dëmtimeve*

janë të kategorisë së plagosjes së lehtë. Këtë qëndrim analog ka mbajtur dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 86 datë 6.3.2013.

Në kohën e ndjekjes së procesit hetimor nga ana ime si prokuror i çështjes, të pandehurit nuk i është komunikuar asnjë akuzë, por ishte person nën hetim. Akuza është komunikuar pas heqjes dorë të të dëmtuarit nga e drejta e ankimit dhe saktësisht të referencës ligjore dhe veprës penale të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal.

Referenca ligjore ka qenë e saktë sipas ligjit të kohës. Gjykata Kushtetuese, në datën 26.2.2016, me vendimin nr. 9, ka vendosur shfuqizimin e paragrafëve 5 dhe 6, të nenit 278, të Kodit Penal, para ndryshimeve të bëra me ligjin 135/2015, datë 5.12.2015, që do të thotë se paragrafët 7 dhe 8 të nenit 278 kanë qenë në fuqi. Në këto rrethana ka rezultuar se paragrafi 3 i dispozitës në fjalë që parashikonte mbajtjen pa leje të armëve luftarake në banesë është shndërruar në paragrafin 5 të këtij neni.

Gjykata e ka gjetur të bazuar dhe kualifikimin ligjor që unë si prokuror i çështjes kam bërë për veprën penale dhe nga ana ime nuk ka pasur asnjë qëndrim favorizues ndaj këtij shtetasi.

Regjistrimi i veprës penale për këtë shtetas në vitin 2018 është bërë bazuar në nenin 278/1 të Kodit Penal. Gjatë fazës së hetimeve rezultoi se shtetasi nuk është ndaluar në mjedise publike, por private, dhe më pas është bërë saktësimi i referencës ligjore bazuar në nenin 278/3 të Kodit Penal me komunikimin e akuzës. Masa e kërkuar e dënimit ka qenë maksimale me 30 muaj burg. Gjykata Pogradec e ka dënuar të pandehurin me 18 muaj burg, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.”

❖ **Për çështjen penale ndaj shtetasve E., dhe E.M., E.D., dhe R.C.**

Në rezultatet shtesë të hetimit subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me çështjen e ndjekur në vitin 2016 dhe më pas për procesin gjyqësor për gjykimin e çështjes penale nr. ***, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ndaj të pandehurve E.M., E.M., E.D., dhe R.C.

Për këtë çështje ka rezultuar se në datën 04.12.2016 është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ngarkim të personave të sipërpërmendur, të dyshuar për veprën penale “*prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike*”. Për këta katër të pandehur është vendosur që vetëm për shtetasit E., dhe E.M., të dërgohet çështja në gjykatë për kryerjen e veprës penale “*prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike*”. Për shtetasin E.D., është kërkuar gjykimi për “*moskallëzim krimi*” dhe, për shtetasin R.D., nuk është ngritur ndonjë akuzë penale.

Në ndjekjen e hetimeve duket se subjekti ka favorizuar disa prej personave të ndaluar, për të cilët është regjistruar vepra penale “*prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike*”.

Për këtë çështje subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me:

- mosndjekjen dhe mosreferencën për veprën penale të referuar nga shteti maqedonas, atë të “*trafikimit të lëndëve narkotike*”;
- favorizimin e ndryshëm të katër shtetasve të hetuar për veprën penale “*prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike*” dhe për shmapien e tyre nga përgjegjësia penale;
- kërkesën për dënim më të ulët të shtetasit E.M., dhe aplikimin më pas të nenit 59 të Kodit Penal, për pezullim dënimi me burgim në raport dhe me shtetasin e dënuar më pak, E. D., për “*moskallëzim krimi*”;

- *mosdërgimin në gjykatë të të pandehurit R.C., bazuar në dokumentacionin që disponohej në dosjen hetimore dhe referimin e akteve nga shteti maqedonas.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti lidhur me këtë çështje deklaroi se:

- Në fillim të procedimit është regjistruar vepra penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” e kryer në bashkëpunim. Nuk ka pasur një hetim paraprak proaktiv dhe akuzat janë ngritur pas sekuestrimit të sasisë së lëndës narkotike në banesën e shtetasve E., dhe E.M.
- Nuk ka pasur favorizim të katër shtetasve, por referenca dhe ngritja e akuzës është bërë në bazë të fakteve dhe të provave të mbledhura gjatë hetimit, lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e tyre.
- Kërkesa e bërë për dënimin minimal të shtetasit E.M., për këtë vepër penale është bazuar te parimi i humanizmit, duke marrë në konsideratë dhe një sërë rrethanash lehtësuese, siç është mosha e tij (sapo kishte përfunduar shkollën e mesme), jetesa vetëm me të ëmën e papunë dhe me vëllanë 5-vjeçar etj.
- Për të pandehurin E.D., gjatë hetimit nuk është provuar dhe nuk është dokumentuar asnjë veprim konkludent në veprimtarinë e kultivimit, prodhimit të lëndëve narkotike. Për këtë shtetas rezultoi se ishte në dijeni të veprimtarisë kriminale të kryer nga shtetasit E., dhe E.M., dhe për këtë është ndryshuar kualifikimi i veprës penale atë “të moskallëzimit të kriminit”.
- Lidhur me shtetasin R.C., gjatë fazës së hetimit nuk rezultoi se ky person ishte i implikuar në këtë veprimtari kriminale dhe as që ishte në dijeni të kryerjes së kësaj veprimtarie nga shtetasit e tjerë të ndjekur penalisht.

❖ **Për denoncimin e bërë nga prokurori Sh.K.**

Në rezultatet shtesë të hetimit subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me denoncim të bërë nga prokurori pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Sh.K. Prokurori Sh.K., ka denoncuar subjektin e rivlerësimit, për të cilin ka paraqitur dhe një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, lidhur me akuzën për ndikim të paligjshëm në vendimmarrjen e funksionarëve publikë.

Lidhur me këtë çështje, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi:

“Kallëzuesi më ka bërë me dije se ka bërë kallëzim penal ndaj meje në Prokurorinë e Rrethit Korçë.

Pranë Prokurorisë së Rrethit Korçë kam depozituar një memo, ku kam parashtruar qëndrimin tim, në lidhje me faktet dhe rrethanat e përmendura në kallëzim.

Prokuroria e Rrethit Korçë, në datën 23.4.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.”

C/1 ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Sotir Kllapi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në katër dokumentet ligjore të paraqitura prej tij, si dhe në pesë dosjet/praktikat e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme, jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo me praktikën gjyqësore.

Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, subjekti përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material i kushton rëndësi elementeve të veprës penale në përputhje me provat, për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore.

Subjekti respekton parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet e përgatitura prej tij, respektojnë dispozitat procedurale penale dhe aktet nënligjore.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe i përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur.

Aktet e përpiluara prej tij konceptohen të ndara në pjesë të qarta e të identifikueshme. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në periudhën dhjetor 2013 e aktualisht subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën e prokurorit, në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec ka ndjekur 234 çështje, të vërtetuara me vërtetimin nr. *** prot., datë 17.1.2018, të kësaj prokurorie.

b) Aftësia për të kryer procedurat administrative/drejtuese

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “Shumë mirë” për aftësitë administruese/drejtuese të treguara.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Administrimi i akteve rezulton të jetë bërë në mënyrë të rregullt nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Sotir Kllapi.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Konstatohet se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar për punën e kryer. Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet/praktikat e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Sotir Kllapi, dhe nga dosjet/praktikat e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga katër dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet/praktikat e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Sotir Kllapi. Në asnjërën prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna të dokumentuara mbi ndonjë shkak paanësie. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit apo raste që subjekti i rivlerësimit, prokurori Sotir Kllapi, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë për të komunikuar

Në dosjet e vëzhguara në format letër dhe në dokumentet e dorëzuara prej subjektit të rivlerësimit, prokurori Sotir Kllapi, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi është i qartë dhe në përputhje me etikën e prokurorit.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në dokumentet ligjore, në dosjet dhe urdhrat e vëzhguar nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, prokurorit Sotir Kllapi, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Sotir Kllapi, rezulton të ushtrojë edhe detyrën e lehtësuesit të ekspertit, në kuadrin e Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, për vitet 2013 – 2016 në aktivitet trajnuese.

Për sa i përket trajnimeve të kryera, subjekti i rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, rezulton të jetë angazhuar në seminare që kanë trajtuar tema të ndryshme si ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2013.

5. Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

Nga verifikimi i të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe strukturave në Prokurorinë e Përgjithshme **nuk rezulton që** subjekti i rivlerësimit, z. Sotir Kllapi:

- të ketë pasur masa disiplinore lidhur me punën e kryer;
- të ketë të dhëna apo indicie të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt në veprime të dyshimta;
- të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale);
- të ketë pasur ndaj tij procedime penale të pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krimet e Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Bazuar mbi çështjet e trajtuara sa më sipër, lidhur me çështjet e shqyrtuara nga subjekti, indicet e paraqitura pranë Komisionit, si dhe bazuar në denoncimet e publikut, nuk rezultoi të jetë gjetur ndonjë problem mjaftueshëm i rëndësishëm për të rezultuar në një vlerësim aftësish profesionale më pak se (ndryshe nga), i përshtatshëm sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriteret e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, Komisioni arrin në përfundimin se:

A. Për vlerësimin e pasurisë

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe të interesave privatë, si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohesh parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato *cash*) dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si prokuror.

B. Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Sotir Kllapi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Sotir Kllapi.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.5.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim Hamitaj
Kryesues

Firdes Shuli
Anëtare

Roland Ilija
Relator

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore